



Planuar / Dorëzuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	12.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	SIKMSHEK	7870	2022
Nr Prot Br Prot Prot No			
Shënjca Prilog Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.948/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.948/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat [redacted] me adresë:

[redacted] kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.Nr.5/2022 i datës 18.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, [redacted] i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 26.10.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. [redacted] ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6460/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.948/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.Nr.5/2022 të datës 18.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore *Ndalim nga 20% të pagës për një periudhë deri në dy (2) muaj*, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe shkeljes së ligjit material.

KOSOVO - Prizren  
18.10.2022  
1000 - 511



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 31.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Ministria e Drejtësisë, ndërsa me datë 09.11.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me shenjen A.nr.948/2022 me numër të protokollit 6460/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 26.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 20.09.2022; Vendimin me shenjen KD.nr.5/2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë i datës 18.10.2022; Vendimin e datës 22.09.2022 të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 22.09.2022; Vendimi i datës 23.09.2022 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së; Vendimi i datës 07.09.2022 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së; Vendimin e datës 03.03.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor i nxjerrë nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm i MD-së; Shkresa përcjellës për iniciimin e procedurës disiplinore dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionin Disiplinor me datë 24.08.2022; E-maili i datës 24.08.2022 dërguar nga [redacted] për [redacted] E-maili i datës 22.08.2022 dërguar nga [redacted] për [redacted] me përmbajtjen e shkrimit të postuar në Nacionale.com; E-maili datës 21.07.2022 dërguar nga [redacted] dërguar për Ministren e Ministrisë së Drejtësisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.10.2022; Përgjigjen e datës 09.11.2022 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankuesit i datës 08.09.2014; Konkursin e brendshëm i datës 24.04.2014; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 29.12.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 22.01.2021; Vendimin e datës 06.09.2022 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore e MD-së; E-mailin e datës 20.09.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin; E-mailin e datës 24.08.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin; E-mailin e datës 22.09.2022 dërguar nga përfaqësuesi i ankuesit për [redacted] Procesverbalin e seancës e Komisionit Disiplinor të datës 14.10.2022; Përmbajtje e publikeve të bëra nga portali Nacionale.com; Postimin e ankuesit në rrjetin social "facebook"; Procesverbalin e seancës e Komisionit Disiplinor të datës 14.10.2022; Procesverbalin e seancës e Komisionit Disiplinor të datës 11.10.2022; Vendimi i Kryesuesit të Komisionit Disiplinor i datës 22.09.2022; Vendimin e datës 26.08.2022 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar dhe se çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e administruara të lëndës, gjejtë Aktin e Emërimit të datës 08.09.2014 ka konstatuar se ankuesi [redacted] ka statusin e nëpunësit civil dhe mban pozitën e punës *Udhëheqës i Departamentit për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë.*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se paraqitja e shkëljeve të supozuara disiplinore ndaj ankuesit ishte bërë nga z. [redacted] Shef i Kabinetit të Ministres së Drejtësisë, përmes Shkresës (e-malit) të datës 22.08.2022, drejtuar Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa ky i fundit, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 24.08.2022 kishte iniciuar procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ku për pasojë Komisioni Disiplinor me Vendimin KD.nr.5/2022 të datës 18.10.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore *Ndalim nga 20% të pagës për një periudhë deri në dy (2) muaj.*



Lidhur me pretendimet ankimore për shkelje procedurale, Kolegji i Këshillit analizoi aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimin KD.nr.5/2022 të datës 18.10.2022 të Komisionit Disiplinor, dhe si rrjedhojë vlerësoj se i njëjti përmban të meta esenciale që pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së tij, kjo për faktin se me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 përcaktohet se: 1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.* 2. *Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij,* ndërsa akti i kontestuar nuk përmban një paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës, gjegjësisht pretendimet për shkelje disiplinore si dhe kualifikimin e shkeljeve nga udhëheqësi i drejtpërdrejt, siç kërkohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor nuk është lëshuar fare në vlerësimin e çështjeve procedurale të cilat janë parakusht për marrjen e një vendimi të drejt dhe të ligjshëm në një procedurë administrative.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, përkatësisht nenin 48 paragrafi 2 përcaktohet se: 2. *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, si dhe nenin 7 paragrafi 1, 2, 4 dhe 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: 1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë. 2. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore brenda afateve të përcaktuara në nenin 48 paragrafin 7 të Ligjit. 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit.* Andaj, referuar këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit vlerëson se parakusht për zhvillimin e një procedure disiplinore nga Komisioni Disiplinor është konstatimi i faktit nëse shkeljet e pretenduara janë kualifikuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, sepse nga konstatimi i kësaj çështje rrjedh pastaj edhe kompetenca lëndore për trajtimin e çështjes administrative nga Komisioni Disiplinor, në kuptim të nenit 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu, me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht nenin 11 përcaktohet se: 1. *Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore,* nga rrjedh se Komisioni Disiplinor është kompetent për shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë me qëllim të vërtetimit të shkeljeve të supozuara nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i cili konsiderohet edhe iniciues i procedurës disiplinore.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të goditur me ankesë, vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj faktin nëse udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit si iniciues i procedurës disiplinore, pas pranimit të njoftimit të datës 22.08.2022, të ketë bërë



kualifikim e shkeljeve të pretenduara, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 7 paragrafi 4 dhe 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërlidhur me nenin 46 dhe 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ashtu sikurse edhe konstatimin e kompetencës lëndore për trajtimin e kësaj çështje nga Komisionit Disiplinor.

Andaj, për sa me sipër dhe duke qenë se Vendimi KD.nr.5/2022 i datës 18.10.2022 i Komisionit Disiplinor përmban të meta të tilla të natyrës procedurale të cilat pamundësojnë vendosjen meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesi është e bazuar dhe si rrjedhojë vlerësoi që kjo çështja disiplinore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë.

Komisioni Disiplinore, në procedurë të rivendosjes, duhet t'i marr parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminoj të metat e aktit administrativ, duke konstatuar fillimisht nëse janë respektuar dispozitat ligjore nga iniciuesi i procedurës disiplinore në kuptim të kualifikimit të shkeljeve të supozuara, dhe rrjedhimisht ekzistimin e kompetencës lëndore në kuptim të nenit 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe vetëm pas konstatimit lidhur me respektimin e dispozitave ligjore procedurale, të ndërmarr veprime për trajtimin e çështjes në meritë dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.948 /2022

**Elakron GASHI**

*Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional*

**Eshref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së